



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 15.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **07.08.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Arch Empire LLC, me shifren **0306**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime” me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Arch Empire LLC, me shifren **0306** e dt. 07.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime” me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3, kundër NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT - REZULTATET E VLERËSIMIT ARTISTIK të datës 02.08.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT i datës 02.08.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-qov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik Arch Empire LLC, me shifren **0306** me date 07.08.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime” me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3. Autoriteti Kontraktues, me datë 15.08.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:



**Neni 1 Qëllimi**

**Neni 2 Fushëveprimi**

**Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

**Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo — Diskriminimi**

**Neni 10 Mjetet për promovimin e transparences**

**Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tendereve**

**Neni 60 Kriteret për dhënien e kontratës**

#### **Pretendimet ankimore**

AK, me date 02.08.2023 ka publikuar njoftimin për vendimin e AK-se lidhur me vlerësimin dhe poentimin e projekteve ideore të paraqitura nga aplikuesit për këtë Konkurs të projektimit. Të pakenaqrur me numrin e pikeve, vlerësimin dhe poentimin e projektit ideor me shifë 0306 kemi kërkuar qasje e dokumentacion konkretisht shikimin e projekteve ideore me shifra 8485 dhe A3P7 të cilat janë poentuar me pike me shume se sa projekt idea me shifer 0306 të cilën kemi paraqitur ne. Me date 05.08.2023 ne kemi parashtruar Kerkese për qasje në dokumentacion por nuk kemi marr konfirmimin për leje në qasjen e kërkuar.

Kjo ka vështirësuar përgaditjen e kesaj kerkese për rishqyrtimin të vendimit të AK për poentim, po thuaj e ka bërë të pamundur. Megjithatë për shkak të fataveve ligjore ne po paraqesim këtë kerkese për rivlerësim.

Pretendimi 1: Komisioni për vlerësim profesional ka nxjerr rezultate diskriminuese, duke poentuar propozimin tonë me pike më pak se dy shifrat e lartcekura. Grupi ynë ka paraqitur një projekt të kompletuar dhe në përputhje të plote me kërkesat e detyrës projektuese të dhënë në materialin tenderues. Të dy konkurentët tane janë poentuar me më shumë pike edhe pse nuk kanë përmbushur kriteret dhe kërkesat e paraqitura në Specifikimet teknike të detyrës projektuese. Poentimi është dhënë në kundërshtim të plote me çelësin e funksionimit dhe realizimit të objektit për pozicionin ku është planifikuar. Kthinat e paraqitura nga konkurentët nuk plotësojnë sipërfaqet e kërkuara në detyrën projektuese dhe janë në kundërshtim me specifikat e funksionimit racional e të mirëfillt profesional. Ka kthina dhe kërkesa të pa plotësuara fare nga këta dy konkurentë. Projekti ideor i paraqitur nga konkurentët është pozicionual në lokacion në mënyrë jo të përshtatshme për shkak të veqorive specifike që ka lokacioni, pozicionimi i tillë vështirëson funksionimin e objektit dhe qëllimin e QKMF-se në përgjithësi. Objekti nuk është trajtuar fare nga aspekti i sigurisë dhe nuk janë paraqitur elementet bazë të sigurisë. Masat dhe trajtimi i personave me aftësi të kufizuara nuk është marrë në konsideratë. Janë paraqitur hapsira të shfrytëzuara në mënyrë jo profesionale e që ndërferojnë aktivitetet mjeksore dhe drejtpërdrejtë dhe tërthorazi në zvogëlimin e çelësisë së shërbimeve. Nuk janë respektuar standardet e sigurisë së objektit. Koridoret, shkallet dhe ashensorët nuk janë në përputhje me standardet teknike, pozicionimi i tyre në pozita të papërshtatshme, dimensionet nuk plotësojnë standardet epr objekteve të tilla, Qasja e personelit dhe pacientëve nuk është studiuar fare, ka disproporcion të dukshëm në paraqitjen e projektit dhe kërkesave në detyrë projektuese. Parametrat e poentimit të paraqitura në dosjen e tenderit nuk janë respektuar fare. Eficienca e energjisë nuk është marrë fare parasysh nga asnjëri konkurent i poentuar me shumë se ne. Levizja e automjeteve dhe Parkingjet janë dukshëm më dobët të planifikuara se sa propozimi ynë, Shfrytëzimi dhe racionalizimi hapsinor, respektimi i programit dhe detyrës projektuese janë shumë më të dobëta se sa propozimi ynë. Paraqitja grafike është më mungesë të shumta në dimensionet dhe kuotim të kthinave, Racionaliteti inxhinierik është shumë më i dobët në të dy propozimet idetive të paraqitura dhe poentuar me shumë se propozimi ynë. Përkrahimi teknik nuk është paraqitur fare nga asnjëri propozim i poentuar me lartë se propozimi ynë. Për më tepër asnjëri propozim nuk ka paraqitur vlerën financiare të kostos së ndërtimit të objektit që lidhet drejtpërdrejtë me aspektin ekonomik. Në përgjithësi kriteret e paraqitura në dosjen e tenderit pika 23.1 nuk janë respektuar fare. Poentimi është bërë shumë sipërfaqesisht dhe pa u analizuar fare.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 15.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **07.08.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Arch Empire LLC, me shifren **0306**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime**” me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3, **nxjerr**:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Arch Empire LLC, me shifren **0306** e dt. 07.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime**” me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3, kundër NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT - REZULTATET E VLERËSIMIT ARTISTIK të datës 02.08.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT i datës 02.08.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net> .

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik Arch Empire LLC, me shifren **0306** me date 07.08.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime**” me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3. Autoriteti Kontraktues, me datë 15.08.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:



**Neni 1 Qëllimi**

**Neni 2 Fushëveprimi**

**Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**

**Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo — Diskriminimi**

**Neni 10 Mjetet për promovimin e transparences**

**Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tendereve**

**Neni 60 Kriteret për dhënien e kontratës**

#### **Pretendimet ankimore**

AK, me date 02.08.2023 ka publikuar njoftimin për vendimin e AK-se lidhur me vlerësimin dhe poentimin e projekteve ideore të paraqitura nga aplikuesit për këtë Konkurs të projektimit. Të pakenaqur me numrin e pikeve, vlerësimin dhe poentimin e projektit ideor me shifë 0306 kemi kërkuar qasje e dokumentacion konkretisht shikimin e projekteve ideore me shifra 8485 dhe A3P7 të cilat janë poentuar me pike më shumë se sa projekt idea me shifër 0306 të cilën kemi paraqitur ne. Me datë 05.08.2023 ne kemi parashtruar Kerkese për qasje në dokumentacion por nuk kemi marrë konfirmimin për leje në qasjen e kërkuar.

Kjo ka vështirësuar përgaditjen e kësaj kerkese për rishqyrtimin të vendimit të AK për poentim, po thuaj e ka bërë të pamundur. Megjithatë për shkak të fatave ligjore ne po paraqesim këtë kerkese për rivlerësim.

Pretendimi 1: Komisioni për vlerësim profesional ka nxjerr rezultate diskriminuese, duke poentuar propozimin tonë me pike më pak se dy shifrat e lartëcekura. Grupi ynë ka paraqitur një projekt të kompletuar dhe në përputhje të plotë me kërkesat e detyrës projektuese të dhënë në materialin tenderues. Të dy konkurentët tane janë poentuar me më shumë pike edhe pse nuk kanë përmbushur kriteret dhe kërkesat e paraqitura në Specifikimet teknike të detyrës projektuese. Poentimi është dhënë në kundërshtim të plotë me çelësin e funksionimit dhe realizimit të objektit për pozicionin ku është planifikuar. Kthinat e paraqitura nga konkurentët nuk plotësojnë sipërfaqet e kërkuara në detyrën projektuese dhe janë në kundërshtim me specifikat e funksionimit racional e të mirëfillt profesional. Ka kthina dhe kerkese të pa plotësuara fare nga këta dy konkurentë. Projekti ideor i paraqitur nga konkurentët është pozicionual në lokacion në mënyrë jo të përshtatshme për shkak të veqorive specifike që ka lokacioni, pozicionimi i tillë vështirëson funksionimin e objektit dhe qëllimin e QKMF-se në përgjithësi. Objekti nuk është trajtuar fare nga aspekti i sigurisë dhe nuk janë paraqitur elementet e bazës së sigurisë. Masat dhe trajtimi i personave me aftësi të kufizuara nuk është marrë në konsideratë. Janë paraqitur hapsira të shfrytëzuara në mënyrë jo profesionale e që interferojnë me aktivitetet mjeksore dhe drejtpërdrejtë dhe tërthorazi në zvogëlimin e çelësisë së shërbimeve. Nuk janë respektuar standardet e sigurisë së objektit. Koridoret, shkallet dhe ashensorët nuk janë në përputhje me standardet teknike, pozicionimi i tyre në pozita të papërshtatshme, dimensionet nuk plotësojnë standardet epr objekteve të tilla, Qasja e personelit dhe pacientëve nuk është studiuar fare, ka disproporcione të dukshme në paraqitjen e projektit dhe kërkesave në detyrë projektuese. Parametrat e poentimit të paraqitura në dosjen e tenderit nuk janë respektuar fare. Eficienca e energjisë nuk është marrë fare parasysh nga asnjëri konkurent i poentuar më shumë se ne. Levizja e automjeteve dhe Parkingjet janë dukshëm më të dobëta të planifikuara se sa propozimi ynë, Shfrytëzimi dhe racionalizimi hapsinor, respektimi i programit dhe detyrës projektuese janë shumë më të dobëta se sa propozimi ynë. Paraqitja grafike është më mungesa të shumta në dimensionet dhe kuotim të kthinave, Racionaliteti inxhinierik është shumë më i dobët në të dy propozimet idetive të paraqitura dhe poentuar më shumë se propozimi ynë. Përkrahimi teknik nuk është paraqitur fare nga asnjëri propozim i poentuar më lartë se propozimi ynë. Për më tepër asnjëri propozim nuk ka paraqitur vlerën financiare të kostos së ndërtimit të objektit që lidhet drejtpërdrejtë me aspektin ekonomik. Në përgjithësi kriteret e paraqitura në dosjen e tenderit pika 23.1 nuk janë respektuar fare. Poentimi është bërë shumë sipërfaqesisht dhe pa u analizuar fare.



Andaj, përmes kesaj kerkese per rishqyrtim kerkojme qe AK ta shqyrtoj vendimin per poentim te dates 02.08.2023 te AK-se Ministria e shendetesis , ta anuloj kete vendim (marr parasysht ligjin dhe RROUPP-ne dispozitat e sipercekura) dhe të shpall njoftimin per vendimin e poentimit real e profesional.

#### **Dëmet materiale**

Per realizimin e konkurimit ne kete procedure prokurimi. OE ankimues ka perfshire asetet e veta dhe ka angazhuarmjete financiare te konsiderueshme. Perveq demit material/financiar, OE i jane shkatuar edhe deme tjera rrethore si demtimin i reputacionit, ngarkesat psikologjike etj. Humbja konsiderohet 30,000 €

#### **Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore**

I kemi shqyrtuar pretendimet ankimore te Kërkesës tuaj për Rishqyrtim dhe i kundërshtojmë si te pa bazuara. Sa i përket pretendimit se nuk u kemi ofruar qasje ne dokumentacion pas Kërkesës për qasje te datës 05.08.2023, ne sistemin e-prokurimi nuk ka ndonjë kërkesë për qasje ne dokumentacion siç ju pretendoni, përndryshe do u kishim ofruar qasje pa asnjë hezitim, siç u kemi ofruar edhe disa kompanive tjera te interesuara për këtë AP.

Sa i përket pretendimit se nuk është bere vlerësimi i drejte i projektit tuaj dhe se rezultatet e vlerësimit janë diskriminuese, duke radhitur projektet ne mënyre jo te drejtë, ne e kundërshtojmë si te pa bazuar, te pa argumentuar dhe përshkrimi i arsyeve nga ana juaj është mjaft i pa qartë, me shume gabime si nga aspekti drejtshkrimor dhe përmbajtësor. Shume aspekte teknike te cekura ne kërkesën tuaj për rishqyrtim, nuk janë obligim i kësaj faze te projektit ideor, por janë obligim i kompanisë ne fazën e me vonshme te përgatitjes se projektit detaj.


Është i pa bazuar pretendimi se **Qasja e personelit dhe pacienteve nuk është studiuar fare**, kur dihet se projekti i përzgjedhur me me se shumti pike, ka qasje shume te lehte për personelin dhe pacientet, ne nivelin e sipërfaqes se tokës dhe me korridore te drejta, i trajtuar ne nivelet e sipërfaqeve dhe me shfrytëzim te shëtitoreve.

Projektet janë vlerësuar nga Juria Profesionale e caktuar me Vendim te ZKA-se, ne përputhje me nenin 80 te LPP-se. Juria ka qene ne përbërje prej tre inxhinierëve, dy (2) Arkitekt dhe një (1) inxh. e Ndërtimtarisë. Vlerësimin e projekteve e konsiderojmë si profesional dhe përzgjedhja e projekteve nga juria është mandatorë për AK-MSh.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**



**Berat Marmullaku**

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**